



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

RAPORTI VJETOR

2017



*Të jetojmë nga toka
dhe puna jonë*

Fjala e drejtorit të IADK-së

Që nga themelimi IADK vazhdon të përkrahë fuqishëm sektorin e Bujqësisë në Kosovë.

Me qëllim të informimit, ngritjes së transparencës, komunikimit dhe llogaridhënies, IADK edhe këtë vit publikon raport vjetor për të informuar donatorët, partnerët, fermerët dhe të gjithë të interesuarit të tjerë për përparimin që kemi bërë drejt arritjes së qëllimeve tona strategjike në kontributin dhënë zhvillimit të bujqësisë në Kosovë.

Arritjet e organizatës tonë si liderë në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë, në zbatimin e projekteve, kryerjen e shërbimeve ndaj palëve, krijimin e partneritetit të qëndrueshëm me partneret tanë gjatë vitit 2017 tregojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një bazë të shëndetshme për zhvillime të mëtejshme në vitet në vazhdim.

Përkundër thatësirave dhe kohës të pavolitshme për kultivim bujqësor IADK ka arritur që përmes fondeve dhe granteve të saj të zhvillojë dhe të ngris kapacitetin e shumë fermerëve në Kosovë, dhe në përgjithësi të fuqizoj kapacitetin bujqësor të Kosovës.

IADK gjatë këtij viti po ashtu ka promovuar metoda dhe alternitavi të reja në bujqësi si psh.shfrytëzimi i energjisë alternative, bujqësisë organike si dhe përdorimin e duhur të pesticideve dhe plehrave për mbrojtje të mjesidit.

IADK përmes shërbimeve të saj për të gjithë klientët, fermerët, përfituesit ka transmetuar njohuri profesionale për kultivimin e produkteve të në sektorin e bujqësisë.

Ne përmbyllëm me sukses katër projekte:

“Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi”,
“Fuqizimi ekonomik i grave në komunat veriore të Mitrovicës dhe Rajonit ekonomik jugor”,
“Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit” dhe “Krijimi i kushteve të punës në viset rurale dhe rritja e bashkëpunimit në mes të komuniteteve”.

Projektet e zbatuara nga IADK kanë pas një efekt shumë të madh në përmirësimin e jetës së familjeve të përfshira si përfituese të aktiviteteve të ndryshme të projekteve. Përmes këtyre projekteve janë përkrahur grypet e synuara të shoqërisë: familjet në viset e thella rurale, të rikthyerit nga jashtë për shkak të kushteve të vështira sociale, gratë kryefamiljare të cilat kanë jetuar në kushte të rënda ekonomike.

Këto projekte kanë ndihmuar përfituesit të krijojnë biznese në bujqësi, të jenë anëtarë të shoqatave të ndryshme, të legalizohen dhe të jenë pjesë e kooperativave.

IADK në vazhdim të aktiviteteve të saj, do të zbatojë misionin e saj me përkushtim për të arritur sa më shumë rezultate në krijimin e një mjedisi të zhvilluar socio-ekonomik në zonat rurale duke qenë më afër fermerëve dhe në bashkëpunim të ndërsjellë me insitucionet relevante.

Në fund në emër tim, të Bordit të Drejtorëve dhe të punonjësve, do të doja të falënderoj të gjithë ata që ndër vite kanë bërë të mundur suksesin e organizatës së IADK-së, si fermerët ashtu dhe partnerët vendor dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakursyer të tyre në rrugëtimin e përbashkët.

Zenel Bunjaku

TË ARRITURAT NË VITIN 2017

• **Më shumë familje të përkrahura në mënyrë direkte**

182 ekonomi familjare janë përkrahur direkt nga programet e IADK. Akvitetet në të cilat janë përkrahur familjet janë: (serra për kultivim të perimeve, fidanë dhe inpute për mjedër dhe arrë, fidanë dhe inpute për bimë mjekësore, makineri bujqësore, pajisje për bletari, panele solare për prodhimin e energjisë, pajisje për përpunimin e qumështit, pemëve dhe perimeve.

• **Ngritja e kapaciteteve njerëzore në sektorin e bujqësisë**

Gjatë vit 2017, IADK rendësi të veçantë i ka kushtuar edukimit dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore në sektorin e bujqësisë. 3045 fermerë, studentë, inxhinier të bujqësisë dhe punëtorë instucional janë trajnuar në 237 sesione të trajnimeve. Trajnimet kanë përfshirët gjithë sektorët e bujqësisë.

• **Shkëmbimi i përvojave**

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave me vendet dhe organizatat e ndryshme, gjatë këtij viti, IADK ka organizuar 10 vizita në vend, regjion dhe në vendet e BE ku kanë marr pjesë 103 pjesëmarrës.

• **Më shumë vende punë të krijuara**

Bizneset, fermerët e përkrahur nga IADK kanë krijuar mundësi për vetëpunësim dhe punësim për anëtarë të familjes apo individë të komunitet ku jetojnë klientët tanë. Gjatë këtij viti IADK ka ngritur 1.7 ha sipërfaqe me serra për kultivim të perimeve, 0.8 ha në kultivimin e bimëve mjekësore, 6.2 ha sipërfaqe në kultivimin e mjedërës dhe 4.3 ha sipërfaqe në kultivimin e arrës, në sektorin e përpunimit të ushqimit janë krijuar 3 pika përpunuese dhe 1

byfe, janë përkahur 26 bletarë me pako të pajisjeve për bletë, 14 fermerë me mekanizëm bujqësorë, 3 fermerë me panele solare.

• **Zgjerim i mëtejshëm në të gjithë vendin**

Numri i fermerëve të përkrahur për çdo vit është në rritje, çka përbën një bazë të mirë dhe garanci për arritje afatgjate. IADK tani më ka shtrirje të akviteve në të gjitha Komunat e Kosoves

• **Procedura dhe procese të shpejta dhe transparente**

Përzgjedhja e përfituesve, dhe transparenca e gjithë procesit kanë rëndësi për ne. IADK aplikon procesin e përzgjedhjes së përfituesve me anë të poentimit, çka bën të mundur marrjen e vendimit dhe procesin e përzgjedhjes brenda një kohe të shkurtër, transparent dhe pa vonesa.

PARTNERËT DHE DONATORËT E IADK -së GJATË VITIT 2017

Gjatë këtij viti IADK ka vazhduar bashkëpunimin me donatorët me të cilët është krijuar një partneritet afatgjatë në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë. Po ashtu në vitin 2017 IADK ka arritur të krijoj besimin edhe të donatorëve të rinjë në implementimin e projekteve të përbashkëta me qëllim të arritjes së objektivave tona në zhvillimin bujqësisë në Kosovë.

Donatorët e projekteve të përkrahura gjatë vitit 2017 janë:

- **Brot für die Welt (BfdW):** “Mundësimi i vetpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës”
- **Bashkimi Evropian:** “Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi”
- **UNDP:** “Fuqizimi ekonomik i grave në komunat veriore të Mitrovicës dhe Rajonit ekonomik jugor”
- **Ambasada Kanadeze** “Krijimi i kushteve të punës në viset rurale dhe rritja e bashkëpunimit në mes të komuniteteve”
- **HELP** ka kontraktuar IADK-në për ofrimin e shërbimeve këshillimore për klientët të cilët i ka përkrah me pajisje apo mjete për akvitate bujqësore, si dhe ofrimin e trajnimeve ekonomike.
- **GIZ:** “Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit”

- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR):** “Promovimi i kultivimit të mjedrës, mollës, dredhëzës dhe përmirësimi i kualitet të qumësht”

- **“Laboratori për Akvitate të Biznesit” (LAB),** nga Hani i Elezit në kryerjen e shërbimeve profesionale për fermerë, në sektorin e bujqësisë dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për stafin e LAB-it

- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR):** “Promovimi i kultivimit të mjedrës, mollës, dredhëzës dhe përmirësimi i kualitet të qumësht”

- Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe përkrahja direkte e fermerëve me Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës, Skenderaj, Ferizaj, Shtime dhe Zubin Potok.

DEPARTAMENTI I HORTIKULTURËS

NGRITJA E KAPACITETEVE TË FERMERËVE NË HORTIKULTURË

Me përkrahje të donatorëve të ndryshëm gjatë vitit 2017 janë realizuar projekte të rëndësishme për një numër të konsiderueshëm të fermerëve në komuna të ndryshme të Kosovës. Nga ky departament janë zbatuar projekte në fushën e perimtarisë, pemëtarisë, bimëve mjekësore aromatike, mekanizmit bujqësor, energji solare etj. Përveç përkrahjeve direkte për ngritje të kapaciteteve prodhuese për fermerët, njëkohësisht janë ofruar edhe shërbime këshillimore për të avancuar njohuritë e tyre në fusha përkatëse të bujqësisë. Në fushën e perimtarisë edhe këtë vit kanë dominuar kërkesat për ngritje të serrave, ndërsa në pemëtarinë janë ngritur pemishte me fruta të pemëve të imëta (mjedrra), pastaj me drufrytore (arra), derisa të bimët mjekësore aromatike janë ngritur plantacione për kultivim të rignonit të bardhë.

Serrat me sipërfaqe prej 160 m²

Në këtë komponentë janë përkrahur 31 fermerë për ngritjen e serrave për kultivim të perimeve, në kuadër të projektit “Mundësimi i vetëpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës”, i financuar nga donatori BfdW nga Gjermania. Aktiviteti është realizuar në tri komuna: Skenderaj 11 përfitues, Vushtrri dhe Shtime nga 10 përfitues. Secili fermer është furnizuar me serrë me sipërfaqe prej 160m², me konstruksion nga metali i galvanizuar, pastaj me nga 500



fidanë të perimeve, folje të zezë për mulqirim të tokës, sistem të ujitjes dhe rrjetë të gjelbër për hijezim të serrës. Varësisht nga vet përcaktimi i përfituesve serrat janë mbjellë me domate, tranguj dhe specia, apo mbjellje e kombinuar me dy llojeve të ndryshme të perimeve. Me përfituesit paraprakisht janë mbajtur nga dy sesione të trajnimeve, ku janë trajtuar temat për menaxhim të biznesit të fermës dhe mbajtje të shenimeve. Ndërsa për praktikatat e kultivimit të perimeve në serra gjatë vegjetacionit janë kryer nga pesë këshilla direkte për secilin përfitues.

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave me kultivues më të avancuar të perimeve në Kosovë, IADK ka organizuar një vizitë njëditore me përfituesit e serrave, ku janë vizituar kultivues të mëdhenj të perimeve në serra; një në Vushtri dhe një në Podujevë, nga përvojat e të cilëve janë bartur informacione të rëndësishme për kultivimin e perimeve dhe shfrytëzimin racional të serrave.

Prodhimi i perimeve të të gjithë përfituesit është



realizuar me sukses, ndërsa të hyrat nga shitja e perimeve ndryshon në varësi të llojit të perimeve që janë kultivuar, vendit dhe mënyrës së plasimit të perimeve, lëvizjeve të çmimeve të perimeve në tregun me shumicë etj. Pas përpunimit të të dhënave nga 31 përfituesit e serrave, është nxjerrë mesatarja e prodhimit nga një serrë që është afërsisht 2700 kg, dhe të hyrat mesatare për përfitues janë 1150 €. Derisa ka raste individuale që prodhimi maksimal në serrë ka shkuar deri në 3650 kg, ndërsa të hyrat nga shitja e prodhimit nga serra ka arritur vlerën 1500 €, varësisht nga lloji i perimeve dhe gjindshmëria e fermerit në treg, kualiteti i prodhimit etj. Pas heqjes së perimeve kryesore, serrat janë mbjellë me perime vjeshtore dhe në këtë mënyrë fermerët do të kenë të ardhurat shtesë nga kultivimin i dytë i perimeve siç janë sallata, qepë, spinaq etj, dhe të ardhurat mesatare për serrë do të jenë afër 1700 €.

Serrat me sipërfaqe prej 200 m²

Ngritja e 59 serrave me sipërfaqe prej 200 m² është realizuar gjatë muajve shtator-nëntor 2017, në kuadër projektit “Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit” në komunat: Lipjan, Shtime dhe Vushtrri, përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Përfitues të këtyre serrave janë 33 fermerë nga Vushtrria, 17 nga Lipjani dhe 9 nga Shtimja. Pakoja përkrahëse përveç serrës përmbanë edhe sistemin e ujitjes, foljen e zezë për mulqirim, rrjetën e gjelbër për hijezim, agrofoljen për mbrojtje të perimeve nga temperaturat e ulëta, si dhe material mbjellës për sezonën vjeshtore si farëra të spinaqit, qepujka apo fidanë të sallatës, varësisht nga përzgjedhja e vet përfituesve.

Me përfituesit po ashtu janë mbajtur trajnime grupore për menaxhim dhe mbajtje të shënimeve të fermës, ndërsa për vendin dhe pozitën më të mirë



për vendosjen e serrës, si dhe praktikën e kultivimit të perimeve në sezonën vjeshtore janë ofruar këshilla direkte të secili përfitues. Të gjithë përfituesit kanë kryer mbjelljen e serrës me një apo kombinim të dy kulturave të lartcekura perimore, dhe me përkushtim të lartë janë përkujdesur për të arritur një prodhimtari sa më cilësor të perimeve në stinën vjeshtë-dimër.

Kultivimi i rignonit të bardhë

Edhe këtë vit IADK ka punuar në sektorin e bimëve mjekësore aromatike, duke përkrahur katër fermerë në kultivimin e rignonit të bardhë. Sipërfaqet e fushave kultivuese me rigon të bardhë janë me nga 2000 m², ndërsa përfitues janë dy fermer nga Vushtrria dhe dy nga Skenderaj.

Fermerët kanë përfutur pakon mbështetëse e cila përmban:

- Fidanët e rignonit të bardhë;

- Sistemin komplet të ujitjes pikë-pikë;
- Nga një serrë tharëse prej 50m² për tharjen e rignonit pas kositjes;



Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Mundësimi i vetëpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës”, i financuar nga donatori BfdW nga Gjermania. Mbjellja e fidanëve është bërë gjatë sezonës vjeshtore ndërsa prodhimi i masës bimore dhe përfitimet nga kositja e rignonit do të fillojnë nga viti i ardhshëm për të vazhduar edhe për 5-6 vite radhazi. Krahas përkrahjes direkte përfituesit janë mbështetur edhe me trajnime dhe këshilla profesionale për praktikën e kultivimit, kositjes, tharjes dhe deponimit të rignonit.

Kultivimi mjedres

Në këtë aktivitet janë mbështetur 31 fermerë për ngritjen e pemishteve me mjedër në sipërfaqe me nga 2000 m². Përfituesit kanë marrë nga 2000 fidane të mjedrave, si dhe pakon përcjellëse me inpute të nevojshme për këtë aktivitet. Ngritja e këtyre pemishteve është një investim i rëndësishëm për fermerët përfitues, ngase do të krijojnë të hyra afatgjate për së paku 15 vite, me të hyra mesatare të pritshme vjetore nga 4000-6000 €. Po ashtu fermerët kanë ndjekur trajnimet dhe këshillat profesionale që ka organizuar IADK dhe kështu kanë përfutur njohuritë profesionale për kultivim të mjedrave, të cilat do të ju ndihmojnë për të zgjeruar sipërfaqet prodhuese me këtë bimë mjaft fitimprurëse.



Vizita studimore me fermer në Kosovë

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave në mes të fermerëve është organizuar një vizitë studimore me fermerët të cilët merren me kultivimin e mjedrës. Në vizitë kanë marrë pjesë 25 fermerë ku është vizituar një pemishte intensive me mjedër si dhe një pikë grumbulluese e mjedrës në Shtërpçë.



Kultivimi i arrës

Në këtë aktivitet janë mbështetur 7 fermerë për ngritjen e pemishteve me arra në sipërfaqe me nga 5000 - 10000 m². Përfituesit kanë marrë fidanë të arrës, si dhe pakon përcjellëse me inpute të nevojshme për këtë aktivitet siç janë: sistemi i ujitjes pikë-pikë, rezervuarin e ujit me kapacitet prej 3000 litrash, plehrat kimike si dhe telin dhe shtyllat për rrethojnë e pemishtes. Ngritja e këtyre pemishteve është një investim i rëndësishëm për fermerët përfitues, ngase do të krijojnë të hyra afatgjate. Po ashtu fermerët kanë përfiturar njohuritë bazike për kultivim dhe zgjerim të sipërfaqeve prodhuese me këtë bimë.



Ceremonia e certifikimit të përfituesve të projektit GIZ

Në kuadër të zbatimit të projektit "Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit" në komunat Lipjan, Shtime dhe Vushtri, përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH i mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, IADK ka organizuar ceremoninë e

certifikimit të 93 përfituesve të projektit të cilët kanë marrë të mira nga grantet e përkrahura nga IADK.



Projekti është shtrirë në 3 komuna: Vushtri ku janë përkrahur 49 përfitues, Lipjan 35 përfitues dhe Shtime 11 përfitues. Grupe të synuara ka pasur personat e riatdhesuar dhe familjet e tjera në zonat rurale që kanë kushte të mira toke për prodhimin, shitjen dhe hyrjen në treg.

Përfituesit po ashtu janë përkrahur edhe me trajnime si: menaxhim biznesi dhe mbajtje të librave të fermës, 5 sesione me këshilla profesionale të drejtpërdrejta që lidhen me aktivitetin e grantit, informata për shitjet, çmimet e produkteve, promovimin më të mirë në lidhje me kompanitë e përpunimit, promovimi i praktikave të mira bujqësore, monitorim dhe këshillim të vazhdueshëm, këshillime rreth hyrjes në treg dhe rëndësisë së kontratës si dhe asistencë për të legalizuar bizneset e reja, regjistrimin e fermave, bashkim në shoqatë apo kooperativë. Për të gjithë përfituesit e projektit janë shpërndarë certifikata profesionale që përmbajnë kredi të fituara gjatë këshillave dhe trajnimeve nga ekspertët e IADK-së.



Më datën 12/12/2017 u mbajt ceremonia e certifikimit të përfituesve të GIZ në Qendrën Edukuese të Fermerëve në IADK ku u ftuan të gjithë përfituesit e projektit, zyrtarët e komunave si dhe përfaqësuesit e GIZ.

PROMOVIMI I PËRDORIMIT TË ENERGJISË SOLARE NË BUJQËSI

Me qëllim të rritjes së njohurive për mundësitë e shfrytëzimit të energjisë diellore në fushën e bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera në zonat rurale të rajonit të Mitrovicës, IADK ka punuar edhe fushën e promovimit të energjisë alternative. Ky aktivitet është mundësuar nga projekti "Rritja e vetëdijes dhe stimulimi i përdorimit të energjisë alternative në bujqësi për të rritur qëndrueshmërinë e mjedisit dhe rritjen e ekonomisë së gjelbër", i financuar nga Ambasada Kanadeze – Fondi Kanadez për Iniciativa Lokale (CFLI). Projekti ka mbështetur tre fermerë me pajisje për prodhimin e energjisë së rinovueshme nëpërmjet paneleve fotovoltaike, e cila do të përdoret në bujqësi dhe ka ndikim në mbrojtjen e mjedisit dhe për të zvogëluar koston e prodhimit. Pajisjet e instaluar do të shërbejnë si shembull për fermerë tjerë që duan të investojnë në fermat e tyre për energjinë e rinovueshme.

Në kuadër të këtij projekti janë kryer një sërë aktivitete, duke përkrahur në mënyrë direkte me pajisje solare nga një fermerë në tri komuna (Vushtrri, Mitrovicë dhe Zubin Potok), si dhe ofrimin e këshillave për përdorimin e pajisjeve solare dhe menaxhimin e fermës.

Ndër aktivitetet kryesore të realizuara përmes këtij projekti janë:

1. Mbështetja e një përfituesi me panele fotovoltaike për prodhim të energjisë elektrike në zonat e thella rurale, ku mungon rrjeti elektrik;
2. Mbështetja e dy përfituesëve me panele fotovoltaike dhe pompa për ujitje;
3. Organizimi i një tryeze të rumbullakët për rëndësinë e energjisë alternative në bujqësi;
4. Dy ditë fushore për promovimin e njësive të energjisë fotovoltaike;
5. Publikimi i dy fletëpalosje për mënyrat e shfrytëzimit të energjisë alternative në bujqësi;



PËRKRAHJA E STUDENTËVE NË PUNË PRAKTIKE

Një komponentë e rëndësishme në kuadër të projektit "Mundësimi i vetëpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës", i përkrahur nga Donatori Bread for the Word nga Gjermania, është edhe përkrahja e studentëve që kanë përfunduar apo janë në përfundim të studimeve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë si dhe Internacional Business College në Mitrovicë (IBCM).

Gjatë vitit 2017 janë përkrahur me trajnime dhe sistemim në punë praktike 10 student/e nga komuna të ndryshme të Kosovës ku është duke u zbatuar projekti. Studentët e përzgjedhur janë sistemuar në punë praktike nëpër kompani dhe institucione për të cilat ata vet janë përcaktuar duke u bazuar në profilin e shkollimit të tyre. IADK gjatë punës praktike përmes projektit i ka kompensuar studentët me një pagë simbolike për të mbuluar shpenzimet e ushqimit, të komunikimit dhe të udhëtimit. Disa nga studentët kanë kryer punën praktike tremujore në IADK, duke përfituar njohuri të rëndësishme në menaxhim të projekteve dhe në praktikën e prodhimit dhe përpunimit në bujqësi.

Qëllimi i punës praktike është që të përgatisë studentët për tregun e punës, të fitojnë njohuri praktike në sektorin e bujqësisë, të lidhin njohuritë e tyre teorike me përvojën praktike dhe në këtë mënyrë do të kenë më të lehtë të qasen në tregun e punës, apo të marrin iniciativë për vetë-punësim dhe krijim të mikro-bizneseve. Nga kontaktet e vazhdueshme që kemi pasur me 10 studentët që kanë përfunduar punën praktike, jemi informuar se 4 prej tyre janë punësuar. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe gjatë dy viteve të ardhshme duke mbështetur nga 10 student në vit për kryerjen e punës praktike.

IADK - MBPZHR

Edhe këtë vit IADK është përkrahur nga MBPZHR për të zbatuar projektin “Promovimi i kultivimit të mjedrës, mollës, perimeve në serra dhe përpunimi i qumështit” e që ka të bëjë me mbajtjen e trajnimeve dhe këshillave profesionale në teren te kultivuesit e mjedrave, mollëve, perimeve në serra dhe te përpunuesit e qumështit. Ky projekt ka pas shtrirje në komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Drenas, Shtime, Lepasoviq dhe Z.Potok. Gjithsej në këto trajnime dhe këshilla profesionale kanë marrë pjesë 120 fermer.

**BASHKËPUNIMI IADK – HELP**

Në kuadër të projektit të financuar nga organizata HELP, janë mbajtur trajnime dhe këshilla profesionale me kultivuesit e mjedrës, kumbullës, mollës, perimeve në serra si dhe fermerve që merren me blegtori dhe bletari. Po ashtu janë mbajtur edhe trajnime për përpunim të frutave dhe perimeve. Pas përfundimit të kshillave të gjithë pjesëmarrësit janë certifikuar.

**DEPARTAMENTI I BLEGTORISË****Përkrahja e bletarëve me pajisje për bletë**

Në kuadër të projektit “Mundësimi i vetëpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës” financuar nga Donatori Brot für die Welt (BfdW) nga Gjermania dhe bashkë financuar nga Komuna e Ferizajt, Skenderaj dhe Zubin Potok, janë përkrahur 20 bletarë me pako me pajisje për bletari nga tri komuna: Ferizaj 10 bletarë, Skenderaj 5 bletarë dhe Zubin Potok 5 bletarë. Në pako janë përfshirë 13 pajisje shumë të nevojshme për sektorin e bletarisë ku do t'i japin shtytje këtij sektori, sepse në mungesë të mekanizmit bletarët kanë humbur shumë kohë dhe produktiviteti ka qenë më i vogël. Përfituesit kanë qenë nga komuniteti shqiptar dhe serb dhe se kanë qenë shumë të kënaqur me pajisjet që u janë dhuruar sepse deri tani kanë punuar me pajisje mekanike të huazuara.



Në kuadër të këtij projektit janë mbajtur trajnime me temat menaxhimi i fermave dhe mbajtja e shënimeve për 20 përfituesit e pajisjeve të bletëve në tri komunat ku janë mbështetur fermerët. Trajnimet janë mbajtur në objektet e kuvendeve komunale nga ekspertët e IADK-së dhe në prani të zyretarëve të komunave. Po ashtu për përfitues janë mbajtur edhe pesë këshilla direkte reth përdorimit të pajisjeve dhe temave të ndryshme për bletë.

Projekti Ecodairy

Ekspertët e IADK-së gjatë këtij vitit në bashkëpunim me disa ekspertë nga Holanda kanë zbatuar projektin Ecodairy Kosovo. Projekti Ecodairy ka për qëllim ngritjen e kualitetit të qumështit tek pjesa e parë e zingjirit, prej prodhuesit deri te transporti.

Projekti Ecodairy ka për qëllime njohjen me situatën në teren se sa janë avancuar fermerët në praktikat e miratë menaxhimit në Kosovë dhe për ti parë pikat e tyre të dobëta në mënyrë që të shkruhet një raport final ku fermerët mund të bazohen dhe ta përmirësojnë kualitetin e qumështit të tyre.



Të gjithë fermerët kanë zgjedhur të ndjekin modulën e gjedheve i cili ka 14 module me 175 orë ku kanë marrë 19 kredi, ndërsa nga lëndët zgjedhore që i kanë zgjedhur në modulet e bletarisë i kanë marrë 4 kredi.

Pjesëmarrja në trajnime nga kandidatët ka qenë mbi 90 % si në mësimin praktik ashtu edhe në mësimin teorik, ku janë nënshtruar tri testeve (vlerësim sumativ), dhe vlerësimi gjatë procesit mesimor si vijueshmëria, pjesëmarrja në diskutime, detyrat e shtëpisë.

TRAJNIME PROFESIONALE NË BLEGTORI

IADK është e angazhuar për zhvillimin e bujqësisë dhe ngritjen e aftësisë profesionale në fushën e bujqësisë. Për të siguruar të rinjtë dhe të rriturit të marrin kualifikime që do të njihen si ekuivalente me ato të dhëna nga institucionet tjera në vend dhe jashtë vendit, IADK është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve - AKK për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimin në sektorin e blegtorisë. Pjesëmarrësit në këto trajnime do të certifikohen si Teknik i Blegtorisë, niveli i III sipas AKK.

Përmes projektit "Mundësimi i vetëpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës" financuar nga donatori Brot für die Welt (BfdW) nga Gjermania dhe bashkëfinancuar me komunën e Vushtrrisë, janë përfunduar trajnimet me grupin e parë nga komuna e Vushtrrisë ku 14 kandidatë kanë vijuar trajnimet për 28 ditë, mësimi ka qenë i ndarë në pjesën teorike e cila është vlerësuar 30% dhe pjesa praktike 70%. Mësimi ka qenë modularë, ku janë paraparë module obligative dhe zgjedhore. Mësimi teorik është mbajtur në hapësirat e IADK-së ndërsa mësimi praktik në fermën model në Dolak.



Në fund të gjithë kandidatët kanë dal para komisionit vlerësues të përbërë nga tre anëtarë:

1. IADK - Z.Fidan Skeraj
2. Shkolla e mesme profesionale "Bahri Haxha" - Vushtri Z.Blerim Gergjalu
3. Shoqata e fermerëve - Z.Milazim Jonuzi



Vizitë studimore nga një grup i fermerëve

Në kuadër të projektit të RESIT në bashkëpunim me IADK është realizuar vizita studimore me një grup të përbërë prej fermerëve (blegtorëve) dhe zyrtarëve të komunave, vizita është bërë në model fermën në Dolak ku fermerët kanë parë sistemin e lirë të gjedheve dhe objektet përcjellëse, sistemin stacionar të mjeljes. U është shpjeguar për rëndësinë që kanë fermat me sistem të lirë në shëndetin e kafshëve në prodhimtari në kualitetin e produkteve dhe në shumëzimin (mbarësimin) më efikas kur kafshëve ju plotësohen kushtet siq është sistemi i lirë i mbajtjes.



Po ashtu në fund është mbajtur një takim në hapësirat e IADK-së ku është diskutuar mes fermerëve dhe stafit të IADK-së rreth problemeve dhe çështjeve të ndryshme që kanë ngritë fermerët.

Vizita ka qenë një ditore dhe është realizuar sipas dinamikës së paraparë ku kanë qenë të pranishëm 24 pjesmarrës.

Përkahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor

IADK përmes projektit "Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit" në komunat Vushtri, Lipjan dhe Shtime, përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH i mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, ka ndihmuar 18 fermerë në sektorin e blegtorisë me mekanizëm bujqësor dhe me pajisje për bletë.

Aktiviteti është realizuar në komunën e Vushtrrisë ku kanë përfituar 8 fermerë, në komunën e Lipjanit 8 fermerë dhe në komunën e Shtimes 2 fermerë.

Po ashtu janë mbajtur dy trajnime për përfituesit me temat: menaxhimi i fermave dhe mbajtja e shënimeve dhe pesë këshilla direkte ku janë shtjelluar tema varësisht kërkesave dhe nevojave të fermerëve.



DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Fuqizimi ekonomik i grave në viset rurale

IADK edhe gjatë këtij viti i ka dhënë prioritet angazhimit të grave në viset rurale dhe grave kryefamiljare me qëllim të krijimit të kushteve më të mira dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Për të arritur këtë qëllim, IADK gjatë këtij viti ka trajnuar grupet e grave në përgatitjen e ushqimit për nxënësit e shkollave, përgatitje të ëmbëlsirave dhe trajnime në përpunimin e pemëve dhe perimeve. Në kuadër të aktivitetit në përgatitjen e ushqimeve të ndryshme për nxënësit janë trajnuar 11 gra në 10 sesione të trajnimeve. Pas përfundimit të trajnimit, gratë kanë marrë njohuri të mjaftueshme në përgatitjen e 8 llojeve të ndryshme të ushqimeve. Po ashtu grupet e grave kanë ndjekur trajnime në aspektin ekonomik në mënyrë të menaxhimit sa me të mirë të bufësë.



Krijimi i byfësë në komunën e Shtimes

Pas përfundimit të trajnimeve për përgatitjen e ushqimit dhe trajnimeve ekonomike së bashku me përfaqësues nga komuna janë përzgjedhur 4 gra (dhe 2 rezervë) të cilat janë punësuar në bufetë e krijuara në SHFMU "Emin Duraku" Shtime, përzgjedhja e së cilës është bërë në koordinim me drejtorinë komunale të Arsimit.

Pas përzgjedhjes komuna e Shtimes ka bërë renovimin e hapësirës së përcaktuar për bufe dhe IADK ka pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për funksionalizimin e bufësë. Me fillimin e vitit shkollor është bërë edhe funksionalizimi i bufësë ku janë punësuar 5 gra në përgatitjen e ushqimit për nxënësit e kësaj shkolle. Përafërsisht 200 nxënës dhe stafi i shkollës ushqehen në këtë bufe. Këto 5 gra arrijnë të krijojnë të ardhura në vlerë mesatare prej 250 – 300 € varësisht nga numri i nxënësve në shkollat e përzgjedhura. Poashtu grupi i grave me kërkesë të komunës kanë filluar përgatitjen e

ushqimit edhe për nxënësit e shkollës "Emin Duraku 1", komuna Shtime.

Krijimi i pikave përpunuese të pemëve dhe perimeve

Pas përfundimit të trajnimeve për përpunimin e pemëve dhe perimeve si dhe trajnimeve ekonomike së bashku me përfaqësues nga komunat Skënderaj, Malishevë dhe Zubin Potok janë përzgjedhur 3 përfitues të pajisjeve Znj.Florije Hyseni nga fshati Izbicë, komuna Skënderaj, Znj.Fatime Limaj nga fshati Banjë e Malishevës, komuna Malishevë dhe Znj.Daniela Radiq Miliq nga fshati Velibreg, komuna Zubin Potok. Pas përzgjedhjes përfitueset kanë bërë renovimet e nevojshme me qëllim të adaptimit dhe përshtatjes së hapësirave private për vendosjen e pajisjeve.



Logo dhe etiketat e produkteve

Disa nga pajisjet me të cilat IADK ka përkrahur pikat përpunuese janë: vitrinë vertikale VV 900 litra, peshore kapaciteti 100kg, duplikator i përshtatshëm elektrik për zierje të pemëve dhe perimeve, makinë për bluarjen e pemëve dhe perimeve, termometër digjital për matjen e temperaturës së masës gjatë zierjes së produkteve, lavaman me dy gropa dhe pushimore, tavolin pune e mbyllur me një raft, raft për pajisje, lavaman për larjen e duarve, blender dore, sistem ventilimi, mbushës të produkteve të pemëve, pasterizator 100 litra, Refraktometer, 28-62% Brix etj.



Promovimi i pikës përpunuese në fshatin Veljibreg, komuna Zubin Potok

Me qëllim të legalizimit dhe promovimit të tyre IADK ka përkrahur regjistrimin në biznese, sigurimin e barkodeve nga ODA EKONOMIKE E KOSOVËS si dhe krijimin e llogove dhe dizajnimin e etiketave për 5 produkte për secilën pikë përpunuese, gjithsejtë 15 produkte të standardizuara. Janë organizuar edhe ditët promovuese në të cilat kanë qenë përfaqësues të komunave, përfaqësues të IADK-së dhe gratë pjesëmarrëse të trajnimeve.



Promovimi i pikës përpunuese në fshatin Banjë, komuna Malishevë



Logo dhe etiketat e produkteve



Logo dhe etiketat e produkteve

Përfitueset e pajisjeve kanë arritur të krijojnë vende të veçanta për përpunimin e pemëve dhe perimeve me të gjitha kushtet të cilat duhen plotësuar që të respektohen rregullat në aspektin higjieno-sanitar.

IADK përkrah grupet e grave në regjistrimin e grupeve të tyre në biznese

Janë krijuar dy biznese, njëra në komunën e Skënderajt, dhe tjetra në komunën e Shtimes. IADK ka mbështetur pikën përpunuese të pemëve në fshatin Izbicë dhe byfen e shkollës "Emin Duraku", Shtime në funksionimin e bizneseve, dhe ka lehtësuar të gjithë procesin e regjistrimit të tyre, duke përbushur dokumentet për regjistrimin krijimin e logos dhe orientimin e grave në vendet e regjistrimit.

ME QËLLIM TË RITJES SË KAPACITETIT TË GRAVE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË, IADK KA REALIZUAR TRAJNIMET SI VIJON:

1. Trajnimet në modulën e pemëve dhe perimeve
Në këto module janë trajnuar 6 grupe të grave gjithsejtë 132 nga fshati Kopiliq i Epërm, Leçinë, Izbicë komuna e Skënderajt, Banje e Malishevës komuna Malishevë dhe Velijbreg komuna Zubin Potok, ndërsa janë certifikuar 84 pjesëmarrëse. Këto module kanë përmbytur nga 10 sesione të trajnimeve gjithsejtë 60 sesion ku gratë janë trajnuar në përpunimin e llojeve të ndryshme të perimeve dhe pemëve. Është diskutuar për rëndësinë dhe ndikimin e higjienës së pajisjeve në produkt, higjienën në vendin e punës, po ashtu detyrimet në përputhje me higjienën dhe standardet sanitare, komerciale, moral dhe obligimet ligjor. Gjatë trajnimeve është demonstruar në mënyrë praktike përpunimi i perimeve (sallatë e përzier, konservimi i kornishonit, feferonit, specit) dhe pemëve (përgatitja e xhemit të mjedrës, dredhëzës, vishnjës, manaferrës, kompot molle dhe dardhe) u janë dhënë sqarime edhe për produkte tjera për të cilat gratë kanë shprehur interesim, sidomos për rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe standardizimi i produktit si një çështje kyçe për një biznes të suksesshëm.



Edhe pse ishte viti i parë i punës ato arritën të përgatisin produkte mjaft cilësore dhe ti promovojnë ato në panaiet e organizuara nga Komuna e Prishtinës, Mitrovicë, Prizrenit, Ferizajit etj.

Pjesëmarrësve në trajnim iu është shpjeguar për funksionin e secilës pajisje (duplikatorin, blurësen, pasterizatorin) si dhe rrezikun dhe sigurinë gjatë punës. Si pjesë e rëndësishme e trajnimit ka qenë mbajtja e shënimeve gjatë procesit të prodhimit e cila luan rol për zhvillimet e procesit por edhe mundësin e përmirësimit, po ashtu posedimin e të dhënave për sasinë dhe llojet e produkteve, kohën e prodhimit, personat përgjegjës etj. Poashtu iu është përgatitur libri i mbajtjes së shënimeve me qëllim të lehtësimit të formës së mbajtjes së shënimeve.



2. Trajnimet në përgatitjen e ëmbëlsirave

Janë indentifikuar tri grupe të grave, secili grup prej 10 grash të cilat janë trajnuar në 10 seanca trajnimi (10 ditë) për përgatitje të ëmbëlsirave.

Grupi i parë i trajnimeve është realizuar me 22 gratë e interesuara në fshatin Qabër, komuna Zubin Potok, grupi i dytë i trajnimeve është realizuar me 17 gratë e interesuara në komunën e Shtimës si dhe grupi i tretë prej 11 grave është formuar në komunën e Vushtrisë. Trajnimet janë mbajtur nga ekspertë të IADK-së dhe pjesa më e madhe e trajnimit është organizuar në formë praktike me qëllim që pjesëmarrëset të aftësohen dhe fillojnë prodhimin e këtyre produkteve. Poashtu gratë më të interesuara kanë marrë pjesë në dy seanca trajnime ekonomike. Gjatë vitit 2018 ky aktivitet do të vazhdojë tutje, ku do të bëhet përzgjedhja e përfitueses së pajiseve e cila do të përgatitet për fillimin e një biznesi në përgatitjen e ëmbëlsirave.



PROMOVIMI I PRODUKTEVE

IADK ka ndihmuar përfitueset e projekteve, përpunueset në pjesëmarrje në panaiere të ndryshme siç janë:

- Panairi i produkteve bujqësore MBPZHR dhe OEK – janë prezantuar produktet e pikave përpunuese nga 6 gra.
- Panairi regjional “ Mitrovica 2017, 30 fermer cilat kanë bërë shitje të produkteve .



TRAJNIME PROFESIONALE NË PËRPUNIMIN E MJEDRËS DOWN SYNDROM KOSOVA - DSK

Gjatë vitit 2017 IADK ka realizuar një bashkëpunim edhe me organizatën Down Syndrom Kosova me qendër në Prishtinë. Qëllimi i bashkëpunimit ishte trajnimi i stafit dhe personave me Down Syndrom në përgatitjen e xhemit të mjedrës si produkt standard, produkt i cili do të prezantohet në pika të ndryshme të shitjes. Trajnimet kanë përfshirë temat si: higjiena personale, vendit të punës dhe pajisjeve, kosto e prodhimit, standardizimi i produkteve, kualiteti i lëndës së parë, përgatitja e lëndës së parë për prodhim dhe përpunimin e mjedrës në xhem mjedre.



TURIZMI RURAL PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË ZONËS NDËRKUFITARE TË KOSOVËS DHE MALIT TË ZI- viti i dytë

Projekti “Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi” ka filluar të zbatohet në vitin 2016 dhe ka përfunduar gjatë vitit 2017 ku është vazhduar me aktivitetet e planifikuara me qëllim të krijimit të kushteve dhe promovimit të turizmit rural në Komunën e Deçanit dhe Junikut. Në këtë raport janë paraqitur aktivitetet e realizuara në vitin 2017 dhe rezultatet e projektit.

Përkrahja e fermerëve me pajisje për përpunimin e qumështit dhe paneleve solar për prodhimin e energjisë

Pas instalimit të pajisjeve për prodhimin e djathit, stafi i IADK-së ka bërë një monitorim periodik që të ndihmojë fermerët të funksionalizojnë pikat e përpunimit të djathit dhe t'i mësojnë fermerët në përmirësimin e metodave të tyre në përgatitjen e produkteve të ndryshme të qumështit gjatë përdorimit të pajisjeve të reja. Në fillim puna ka filluar me përgatitjen e produkteve të njëjta që ata kanë përgatitur më parë, por me metoda dhe pajisje të reja. Kur fermerët filluan të përdorin pajisjet, kanë vënë re vështirësitë e tyre duke përdorur metodat e vjetra dhe gabimet që kanë ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e produktit. Stafi i IADK-së organizoi trajnime shtesë për 5 përfituesit me qëllim që të diversifikojnë produktet dhe ato t'i ofrojnë turistëve.



Pika përpunuese në fshatin Isniq, Komuna Deçan



Pika përpunuese në komunën e Junikut



Panelat solar dhe pajisjet për djath në Ratishtë të ulët, Komuna e Deçanit

Ndërtimi i qendrës informuese të vizitorëve

Meqenëse ky aktivitet ka pasur nevojë për më shumë kohë për zbatim, gjatë vitit 2016 kemi filluar me përgatitjen e dosjes së tenderit dhe ndërtimit të saj. Qendra u ndërtua në komunën e Deçanit, në bllokun që lidh me Monumentin Historik të Deçanit "Manastiri i Deçanit", e cila është pjesë e programit të mbrojtjes së UNESCO-s, kompleksin e hoteleve të vjetra, kompleksin e hoteleve të reja, që mund të akomodojë fëmijët me 660 shtretër, rruga lidhëse me malet e Deçanit" Bjeshka e madhe, Cernabreg, Zalli i Rupes, Mirëshit, Pllaqice e Vokshit, Isniqit, Belegut, Baballoqit etj", Po ashtu komuna e Deçaniy ka inicuar ndërtimin e rrugëve që lidh malet e Belegut, Plavë dhe Ulqin, Malet e Malit të Zi dhe Shkodër, malet e Shqipërisë, kështu që qendra e informacionit do të luaj një rol vendimtar për të informuar turistët dhe gjithë të interesuarit që dëshirojnë të vizitojnë pikat e lartpërmendura.



Trajnimet për familjet mikpritëse dhe restorantet për shërbimet turistike

Në mënyrë që të përmirësohen shërbimet e turizmit nga familjet mikëpritëse dhe restorantet në zonën e Deçanit dhe Junikut kanë vazhduar trajnimet edhe me 4 grupe të tjera.

Një pjesë e këtyre trajnimeve është paraqitur edhe në manualin e publikuar në 400 kopje në tri gjuhë (Shqip, Serbisht dhe Anglisht) "Turizmi malor dhe rural në Komunitet Deçan dhe Junik".



Trajnimet në sigurinë e ushqimit dhe teknologjinë e prodhimit

Për të realizuar trajnimet në sigurinë e ushqimit dhe teknologjinë e prodhimit të djathit janë ftuar në trajnime përfituesit e staneve dhe përfituesit e pajisjeve të përpunimit të djathit. Janë mbajtur 9 seanca trajnimi për sigurinë e ushqimit dhe përpunimin e qumështit në receta të djathta me pjesëmarrjen e 161 grave nga Deçani dhe Juniku. Përveç djathrave tradicionale, tani pjesëmarrësit mund të prodhonin edhe lloje të reja të djathit, të cilat do të ishin të mira nga perspektiva e larmisë së prodhimeve të tyre dhe rrjedhimisht oferta të ndryshme.



Materiali i trajnimit është përgatitur dhe dizajnuar në 500 kopje të manualit që do të përdoren nga fermerët si një referencë pas trajnimit. Poashtu është organizuar ceremonia e certifikimit të fermerëve dhe grave ku ishin të pranishëm 55 pjesëmarrës, duke përfshirë kryetarin e komunës së Deçanit, partnerët nga Deçani, fermerët, gratë etj.



Ceremonia e Certifikimit të fermerëve



Manuali i publikuar "Siguria e ushqimit dhe teknologjia e prodhimit"

Manuali "Siguria e ushqimit dhe teknologjia e prodhimit" është përgatitur dhe publikuar në 500 kopje në tri gjuhë (Shqip, Serbisht dhe Anglisht).

Vizitë studimore në stanet më të suksesshme në Malin e Zi



Kjo vizitë u organizua më 19 dhe 20 Qershor, ku morën pjesë 5 përfaqësues nga Kosova dhe 5 përfaqësues nga Mali i Zi. Pjesëmarrësit ishin pronarët e staneve që kanë filluar të ofrojnë shërbime turistike si akomodimi, ushqimi tradicional si dhe aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrësit kishin mundësi të shohin zhvillimin e staneve në Malin e Zi si një potencial të madh për të ardhurat duke krijuar aktivitete për popullsinë në këtë zonë. Promovimi i ushqimeve tradicionale rajonale si djathë të ndryshëm, "kajmak" dhe shumë produkte të tjera, diversifikimi i veprimtarive të tilla si: kalërimi, vizitat e fermave nga turistët, përdorimi i burimeve natyrore të kësaj ane si: bimë medicinale dhe aromatike, boronica dhe kërpudha të ndryshme.



Promovimi i turizmit rural

Gjithashtu, një nga aktivitetet promocionale është edhe prodhimi dhe transmetimi i videos promovuese. Kompania e përzgjedhur ishte KLAN Kosova, një media shumë profesionale dhe e njohur

në Kosovë dhe së bashku me stafin përgjegjës, është hartuar skenari dhe janë kryer incizimet e videos në teren me qëllim të përfshirjes së të gjitha aktiviteteve dhe promovimin e turizmit rural.

Kjo video është shfaqur në TV në programin ORA SHTATË NË KLAN KOSOVA dhe ORA E PASDITES dhe është publikuar edhe në YOU TUBE ku ka pasur shumë shikueshmëri.

<https://www.facebook.com/Ora7Official/>



Një nga aktivitetet e përbashkëta me Malin e Zi është udhëtimi familiarizues me agjencitë turistike dhe gazetarët. Qëllimi i vizitës ishte promovimi i aktiviteteve të realizuara nga projekti si informacioni i vizitorëve, mbështetja e fermerëve me panele diellore dhe njësi prodhimi të djathit, 13 km shtigje në këmbë, kampingje dhe rrugë për të inkurajuar operatorët turistikë që të përfshijnë në ofertat e tyre të rregullt dhe rritja e numrit të vizitave të organizuara nga grupet e turistëve në vend, si dhe promovimi i tyre.

Për organizimin e këtij udhëtimi, IADK ka kontraktuar organizatën Balkan Natural Adventure nga Peja, ku 25 pjesëmarrës ishin të pranishëm, agjenci turistike nga Peja, Istogu, të cilët janë të angazhuar në turizëm rural dhe malor. Një prej tyre është agjencia Rams që udhëtojnë nga Mali i Zi, gazetar nga RTK, Klan Kosova, Koha Ditore etj., Përfaqësues nga IADK, Golden Honey dhe BNA.



Gazetari nga gazeta Koha ditore si pjesë e grupit ka shkruar artikullin për turizmin e Deçanit <http://www.koha.net/kosove/31971/mrekullite-natyrore-te-decanit-me-infrastrukture-primitive/>, po ashtu udhëtimi është promovuar edhe në <https://www.youtube.com/watch?v=aegBbob2jns>, në emisionin IMAZH në RTK TV dhe <https://www.facebook.com/iadk.org/>

Zhvillimi i platformave të web-marketingut

Për të trajtuar çështjet e mungesës së një platforme virtuale në Kosovë për turistët e interesuar për të vizituar këtë zonë, zhvillimi i platformës së internetit është aktiviteti i partnerit nga Mali i Zi, por stafi i IADK-së ka ofruar informata për pjesën e Kosovës si: shtigjet për këmbësorë, stanet dhe strehimin, ushqimi, malet etj. që agjensitë turistike të jenë në gjendje të paraqesin paketën turistike në një mënyrë për të tërhequr turistët. Për më shumë vizitoni www.katunroads.me

Hartimi i florës dhe faunës së rëndësishme në zonën e projektit

Partneri nga Mali i Zi ka pasur rolin kryesor në këtë aktivitet, por IADK ka ofruar informacion për florën

dhe faunën për zonën ndërkufitare, Deçan dhe Junik. IADK ka një bashkëpunim shumë të mirë me GIZ Kosovë dhe ata kanë informuar IADK se GIZ ka mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të botuar "Librin e kuq të florës vaskulare të Republikës së Kosovës. Libri është paraqitur në faqen e internetit të ministrisë si mund të shkarkohet"

<http://mmph-rks.org/en-us/Publications/THE-RED-BOOK-OF-VASCULAR-FLORA-OF-THE-REPUBLIC-OF-KOSOVO-1578>

Gjithashtu përmes projektit janë shtypur 500 kopje të hartës së biodiversitetit të rrugës së staneve në tri gjuhë.

RRJETËZIMI, PËRFAQËSIMI DHE LOBIMI I IADK-së NË ORGANIZATA TË NDRYSHME NË REGJIONE DHE EVROPË

IADK përveç implementimit të projekteve të ndryshme, dhënies së shërbimeve si dhe ngritjen e kapaciteteve të përfituesve në sektorin e bujqësisë, kontribut të madh ka dhënë edhe në përfaqësimin e saj në shumë organizata në Kosovë, regjion dhe në Evropë. IADK është e anëtarësuar në një numër të madh të rrjeteve vendore dhe internacionale:

Në Kosovë:

1. CiviKos Platform: ku IADK merr pjesë në mënyrë aktive në krijimin e strategjive dhe dokumenteve të ndryshme
2. Rrjeti i Grave të Kosovës - IADK përveç që është anëtare e këtij rrjeti po ashtu është anëtare në bordin e RRGK si dhe në implementimin e projekteve të ndryshme të cilat kanë ndikuar në implementimin e strategjisë së rrjetit 2015-2018 përmes fuqizimit ekonomik të grave.

Në regjion :

1. BAAN - Balkan Agriculture Asociation Network - IADK është një ndër themelueset e kësaj organizate në nivel regjional ku në këtë organizatë janë të përfshira organizata nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja dhe Serbia

2. SEEON - Former BON (Balkan Organic Network) - Rrjeti Organik i Evropës Juglindore - SEEON është një rrjet rajonal që synon të mbështesë zhvillimin e lëvizjes organike në Evropën Juglindore. Anëtarët e SEEON janë aktorë të ndryshëm organikë të përfaqësuar në Asamblenë e Përgjithshme të SEEON. IADK është anëtarë e Bordit të SEEON. Gjatë vitit 2017 IADK ka marrë pjesë në takime Shkup, Maqedoni ku ka kontribuar në krijimin e platformës së kësaj organizate <http://www.seeon.org>



3. SEASN - South East Advisory Service Network - SEASN është një shoqatë e shërbimeve këshillimore bujqësore, odat bujqësore, institutet bujqësore, fakultetet dhe organizatat joqeveritare. SEASN vepron në territorin e anëtarëve të saj, dhe shërbimet këshilluese publike dhe private, konsulentët individualë si dhe institucionet e tjera bujqësore. Anëtarë të këtij rrjeti janë organizatat nga Austria, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Kosova, Maqedonia, Sllovenia dhe Serbia. IADK është anëtarë e kësaj organizate.

Më 21 nëntor 2017 në qytetin e Laskos në Slloveni është mbajtur takimi i SEASN në Hotel Thermana Park Lasko me tema :

- Seminari i 32-të vjetor i Dhomës së Bujqësisë dhe Pylltarisë së Sllovenisë
- Asambleja e dytë vjetore e SEASN
- Konferenca e katërt rajonale e shërbimeve

këshillimore të Evropës Juglindore


Në këtë takim ka marrë pjesë Drejtori ekzekutiv i IADK <http://seasn.eu/>



Në Evropë:

1. EUFRAS - European Forum for Agricultural and Rural Advisory Services - është një rrjet i këshilltarëve të bujqësisë/agentëve të zgjerimit nëpër rajonet dhe vendet e ndryshme evropiane. Kjo organizatë është shumë e suksesshme në marrjen e fondeve për zhvillimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e sistemeve këshilluese bujqësore dhe rurale. EUFRAS është organizata e parë evropiane e shërbimeve këshillimore të fermave dhe është e lidhur me GFRAS. Rrjeti EUFRAS përfaqëson 36 anëtarë nga 25 vende - Armenia, Austria, Belgjika, Belgjika, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Hungaria, Rusi, Slloveni, Spanjë, Zvicër, duke pritur që anëtarët e tjerë të bashkohen në vitet në vijim.

<http://www.eufiras.eu/index.php>



PËRGATITJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE DHE BIZNES PLANEVE

Në hortikulturë janë përgatitur dy biznes plane për fermerë, që kanë aplikuar në grantet e MBPZHR.

PUBLIKIMET

LISTA E FLETËPALOSJEVE TË PUBLIKUARA

Nr.	Titulli i publikimit	Sektori	Donatori
1	Përkrahja e 120 fermerëve me grante	Hortikultura	BfdW
2	Përkrahja e 30 studentëve në punë praktike	Hortikultura	BfdW
3	Përkrahja e 70 përfituesve me grante	Hortikultura	GIZ
4	Përdorimi i energjisë solare në ujitjen e tokave	Hortikultura	CFLI
5	Trajnimet profesionale për fermerë në sektorin e blegtorisë	Blegtoria	BfdW
6	Përdorimi i energjisë solare në njësinë e blegtorisë	Blegtoria	CFLI
7	Pika përpunuese e pemëve dhe perimeve , Izbicë, Skënderaj	Përpunimi	BfdW
8	Bufeja në shkollën "Emin Duraku" në Shtime	Përpunimi	BfdW
9	Pika përpunuese e pemëve dhe perimeve, Veljebreg, Zubin Potok	Përpunimi	UNDP
10	Pika përpunuese e pemëve dhe perimeve , Banjë, Malishevë	Përpunimi	UNDP
11	Krijimi i djathtores në fshatin Isniq, Komuna Deçan	Përpunimi	EU
12	Vendosja e panelave solar në Bjeshkët e Junikut	Përpunimi	EU
13	Krijimi i djathtores në fshatin Prekolluk , Komuna Deçan	Përpunimi	EU
14	Krijimi i djathtores në fshatin Ratishtë e Ulët, Komuna Deçan	Përpunimi	EU
15	Krijimi i djathtores në fshatin Irzniq , Komuna Deçan	Përpunimi	EU
16	Krijimi i djathtores në Komunën e Junikut	Përpunimi	EU

LISTA E BROSHURAVE TË PUBLIKUARA

Nr.	Titulli i publikimit	Sektori	Donatori
1	Siguria e ushqimit dhe teknologjia e përpunimit	Përpunim Ushqimi	EU
2	Turizmi rural dhe malore ne komunat e Deçanit dhe Junikut	Turizëm	EU
3	Histori sukesesi Bujqësia në komunën e Vushtrrisë, Shtimes dhe Lipjanit	IADK	GIZ

VIZITAT E STAFIT DHE VIZITAT ME FERMERË GJATË VITIT 2017

Nr.	Vendi	Datat	Nr. i ditëve	Nr. i pjesëmarrësve	Sektori
1	Kosovë	28.06.2017	1	33	Hortikulturë
2	Kosovë	19.07.2016	1	25	Hortikulturë
3	Kosovë	07.11.2017	1	13	Blegtori
4	Kosovë	17.11.2017	1	25	Blegtori
5	Kroaci	23-29.04.2017	6	2	Financa & Përpunim Ushqimi
6	Maqedoni	28-29.03.2017	1	1	Përpunim Ushqimi
7	Bullgari	21-24.02.2017	3	1	Menaxhment
8	Finland	26-28.09.2017	2	1	Menaxhment
9	Serbi	13-15.11.2017	2	1	Menaxhment
10	Slloveni	21-22.11.2017	2	1	Menaxhment
Total			20	103	

LISTA E STAFIT TË IADK-SË PËR VITIN 2017

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Departamenti	Titulli i vendit të punës
1	ZENEL BUNJAKU	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
2	ESMA AZEMI KËPUZI	Financa, Prokurim & Administratë	Udhëheqëse e departamentit të Financave, Logjistikës dhe Administratës
3	ARIANA SELMANI PECI	Financa, Prokurim & Administratë	Zyrtare për Prokurim dhe Administratë
4	VLORA ZYMBERI	Rekë, Mitrovicë	Zyrtare për Prokurim dhe Administratë - deri më 30.06.2017
5	ELHEME SHALA	Financa, Prokurim & Administratë	Asistente e Financave
6	PETRIT KOCI	IT - Administratë	Mirëmbajtës i rrjetit/sistemit
7	SYLEJMAN BUNJAKU	Hortikulturë	Udhëheqës i departamentit të Hortikulturës
8	SKENDER FEJZULLAHU	Hortikulturë	Inxhinier i Bujqësisë - Pemëtari
9	NOVICA MARKOVIC	Hortikulturë	Inxhinier i Bujqësisë
10	MAGBULE HYSENI	Përpunim ushqimi	Udhëheqëse e departamentit të përpunimit të ushqimit
11	HAFIZE VESELI SYLEJMANI	Përpunim ushqimi	Inxhinier e Përpunimit të ushqimit
12	HANUMSHAHE ZENELI	Përpunim ushqimi	Asistente e Zyrës
13	GURSEL ARIFI	Blegtori	Projekt Menaxher - deri më 28.02.2017
14	FIDAN SKERAJ	Blegtori	Udhëheqës i Departamentit të Blegtorisë
15	ARBER HASANI	Blegtori	Asistent i Blegtorisë
16	SHKURTE BUNJAKU		Asistente teknike
17	FEHMI BASHOLLI		Kujdestar i objektit
18	EGZON GERXHALLIU		Asistent i Projektit
19	ARGJEND GJINOVCI		Asistent i Bujqësisë


LISTA E PRAKTIKANTËVE TË IADK-SË PËR VITIN 2017

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Departamenti
1	FORTIJANA KOVACI	Financa dhe Administratë
2	LIRIKA RACI	Hortikulturë
3	BEHARE MLINAKU	Hortikulturë
4	ESRA KURSHUMLIJA	Hortikulturë
5	SHEFKIJE SADIKU	Hortikulturë
6	ARGJEND GJINOVCI	Përpunim
7	NERIMANE BEQIRI	Hortikulturë
8	EGZONA HAJRA	Hortikulturë
9	GEZIM HAJDARI	Blegtori

TË HYRAT E IADK-SË NGA DONATORËT PËR VITIN 2017

Nr.	Emri i donatorit/partnerit	Emri i projektit	Shuma □	Përqindja %
1	Zyra e Komisionit European në Kosovë	Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi	108,197	14.0%
2	Bread for the World	Mundësimi i vetëpunësimit të të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në zonat rurale në Kosovë	270,795	35.1%
	Komunat (Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Mitrovicë, Skenderaj) dhe Fermerët		68,166	8.8%
3	GIZ	Promovimi i sektorit bujqësor si nxitës për rritje ekonomike dhe punësim	242,734	31.5%
	Fermerët		34,620	4.5%
4	UNDP	Mbështetja e fuqizimit ekonomik të grave në komunat veriore të rajonit të Mitrovicës dhe Rajonit Ekonomik Jugor	28,000	3.6%
	Fermerët		1,569	0.2%
5	Ambasada Kanadeze	Rritja e ndërgjegjësimit dhe nxitja e përdorimit të energjisë alternative në bujqësi për të rritur qëndrueshmërinë e mjedisit dhe rritjen e gjelbër ekonomike	11,301	1.5%
	Fermerët		1,110	0.1%
6	MBPZHR	Promovimi i kultivimit të mjedrës, dredhëzes dhe permirësimit të kualitetit të qumështit	4,000	0.5%
	Gjithsëj		770,492	100%


Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2017, përfshirë edhe të hyrat e shtyera



TË HYRAT E IADK-SË NGA PARTNERËT PËR VITIN 2017

Nr.	Emri i donatorit/partnerit	Emri i projektit	Shuma €	Përqindja %
1	HELP	Trajnime për fermerë	10,444	46.3%
2	LAB	Ngritja e kapaciteteve të organizatës LAB dhe trajnime për fermerë	1,843	8.2%
3	ID Organics	Trajnime për fermerë	1,532	6.8%
4	YUNIKO	Projekti Ecodiary - Blegtori	4,500	20.0%
5	Down Syndrome	Trajnime për përpunim të ushqimit	545	2.4%
6	Diaconia Agapes	Organizimi i vizitave studimore	508	2.3%
7	Care International	Organizimi i vizitave studimore	358	1.6%
8	Caritas Kosovo	Trajnime për fermerë	345	1.5%
9	Të hyrat tjera	Të hyrat e ndryshme për shërbime të fermerëve dhe kompanive të tjera	2,470	11.0%
	Gjithsej		22,546	100%

Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2017





Adresa:

Sfaraçak i Ulët, nr.11
42000 Vushtrri
Kosovë

E-mail: info@iadk.org
Tel: +377 (0) 44 777 036
+386 (0) 49 777 046
Web: www.iadk.org